



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

SEKRETARIATI I NISMES PER TRANSPARENCE
NE INDUSTRIRE NXJERRESE
EITI

Data e takimit | Ora 12/23/2015 12:00 AM | Vendtakimi Salla e Madhe në
Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Takim i thirrur nga

Sekretariati

Shqiptar EITI

Të pranishmit

Antarë të MSG-së

Z. Ilir Bejtja, MEI

Z. Artur Spahiu, Ministria e Financave

Znj. Shilda Kamberi, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

Z. Sami Nezaj, SHC

Z. Ilir Aliaj, SHC

Znj. Anila Hajnaj, SHC

Znj. Madlina Puka

Z. Përparim Alikaj, FIAA

Z. Dritan Dervishaj, Antea Cement

Znj. Migela Xhani

Z. Mehmet Hasanlami, MEI

Znj. Laura Çela, BANKERS PERTOLEUM LTD.

Znj. Ermonela Xhafa, Ministria e Drejtësisë

Të tjerë

Znj. Dorina Çinari, Albania EITI

Z. Agim Shehu, Albania EITI

Znj. Armela Xhaho, Albania EITI

Z. Gëzim Kallajxhi, Albania EITI

Znj. Rudina Konci, Albania EITI

Znj. Anisa Dede, Albania EITI

Znj. Edlira Deda, Albania EITI

Znj. Eni Bajraktari, Albania EITI

Znj. Jonida Vesiu, Deloitte

Z. Elvis Ziu, Deloitte

PROCESVERBAL I MBAJTUR PËR TAKIMIN E DATËS 23. 12. 2015

Çështjet për diskutim:

1. Prezantimi i Raportit Final EITI 2013-2014
2. Diskutim dhe vendim për Raportin Final EITI 2013-2014

Drejtuesi Mbledhjes : Kryetari i MSG Z. Ilir Bejtja

Prezantimi Draft Raportit: Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania (Z. Elvis Ziu, Znj. Jonida Vesiu)

Pjesëmarrja : 13 vetë , anëtarë të MSG dhe të ftuar.

Hapja nga Z. Ilir Bejtja, i cili përshëndeti të pranishmit dhe i pyeti për materialin e marrë dhe mirëpret diskutime pas prezantimit që do bëhet nga Deloitte Audit Albania, bazuar edhe në komentet e diskutimet e mëparshme të bërë për këtë raport.

Znj. Jonida Vesiu, prezanton draft raportin final duke theksuar se:

- janë marrë parasysh sugjerimet, komentet e bëra nga Sekretariati dhe anëtarë të MSG-së në këtë variant që paraqitet.

- vështirësitë e paraqitura për bilancin dhe afatet kohore për rakordimin e të dhënave të paraqitura mes subjekteve private dhe agjencive shtetërore.

- prezantimi paraqet zbatimin e kriterëve EITI, treguesit e përcaktuar dhe disa tregues të rinj përfshirë në këtë raport sipas sektorëve përkatës, diferencat e vogla në rakordimin e bërë mes pagesave të raportuara nga subjektet dhe të ardhurat e marra nga shteti, detajime për treguesit e veçantë për çdo subjekt dhe sipas sektorëve, grumbullimin e rentës minerare dhe shpërndarjen e saj, pasqyrat dhe regjistrimet e lejeve të dhëna për industrinë minerare për çdo subjekt, etj.

- prezantim i veçantë bëhet për sektorin e industrisë hidroenergjetike, si sektor i pasqyruar për herë të parë në raportet EITI për Shqipërinë.

- problemet e dala dhe rekomandimet që jepen.

- çështje apo përgjigje të dala gjatë prezantimit të Raportit EITI 2013 - 2014

Z. Bejtja : Për HEC-et duhet të kemi parasysh :

1. Fee koncesionare mbi sasinë e prodhimit.
2. Taksën e infrastrukturës për Ndërtimin.
3. TVSH.

Problemi dhe rëndësia e sektorit hidroenergjetik shtrohet se në të ardhmen EITI Albania do të rrisë akoma më shumë gamën e sektoreve dhe të treguesve për raportim duke përfshirë këtu edhe:

1. Shpërndarjen e fee-së koncesionare.
2. Shfrytëzimin e burimeve ujore.
3. Mjedisit dhe gjelbërimit.

Znj. Cinari : Vlerësohet të bëhen edhe raportime tematike dhe jo vetëm vjetore bazuar në disa të ardhura të caktuara nga industria nxjerrëse. Një shembull janë raportimet tematike për shpërndarjen e rentës për të parë se si këshillat bashkiakë vendosin se si do menaxhohen ato të ardhura, përshmbull për të dëmshpërblyer komunitetin, rikuperime për tokat apo shpërblime.

Z. Bejtja : Duhet parasysh që të bëhet diferencë midis aseteve shtetërore dhe aseteve të KESH. Kaskada e Drinit dhe e TEC-it Vlorë(që nuk është në punë) i përkasin KESH-it.

Z. Ziu: Ne sugjerojmë një platforme online për raportime për të nxitur dhe për të përshpejtuar procesin e raportimeve në kohë. Bazuar në vështiresitë e hasura gjatë mbledhjes së të dhënave dhe rakordimeve duhet që në raportimet e tjera të merren parasysh disa elementë që do të përmirësonin rritjen e cilësisë dhe përfundimin e raportit në kohë si:

1. Inkuadrimi i EITI-t në kalendarin e raportimeve.
2. Nxjerrja e një manuali përkatës përta i përket grumbullimit të informacioneve.
3. Iniciativa për iniciimin e direktivave.
4. Krijimi i mekanizmave detyrues për raportimet.

Znj. Hajnaj: Shoqëria civile do të mbështesë aktivitetet që do jenë për raportet dhe çështjen EITI duke bashkëpunuar me Sekretariatit dhe kërkuar më shumë nga Ministria e Financave për raportimin e shpërndarjes së rentës minerare në zonat përkatëse. Vihet re se vetem zonat e industrisë së naftës kanë marrë fonde nga shpërndarja e rentes minerare dhe minerare asnjë lek. Kjo nuk duhet të ndodhë aq më tepër që dhe ligji tashmë është ndryshuar për t`ja çuar një pjesë të rentës direkt komunitetit për të zbatuar projektet që ata kanë përgatitur.

Z. Bejtja : Vlerësoj mendimet e trajtimin e problemeve të bëra dhe në rast se jeni dakort të marrim edhe vendim për këtë raport EITI 2013 – 2014. Mesa vërej të gjithë qenkemi dakort për ta miratuar. I takon znj. Cinari të marre masat për ta kaluar këtë raport në procedurat e tjera të njoftimeve të EITI-t qëndror dhe BB si dhe të publikimit.

Për arsye teknike Minutat e Takimit dt. 23. 12. 2015 nuk kanë mundur të regjistrohen të plota. Për këtë arsye po mbahet ky procesverbal i shkurtër në bazë të Materialit të prezantuar nga Administratori i Pavarur, të Vendimit të MSG-së Nr. 5, datë 23. 12. 2015 dhe të shënimeve të mbajtuara nga nëpunësit e Sekretariatit.

Firma për Procesverbalin:

Znj. Dorina Çinari



Z. Agim Shehu



Znj. Rudina Konci



Znj. Anisa Deda



Znj. Emiliana Kola

